



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 850/ prot.

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 63, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. nr. 22, datë 13.2.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 22, datë 13.2.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Has dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 86 (1053 prot.), datë 31.10.2023, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Has”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Has miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Has dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 88, datë 13.10.2025, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 22, datë 13.2.2024, në institucionin Bashkia Has, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr. 850 prot., datë 13.10.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Has me shkresën nr. 850/1 prot., datë

13.10.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 22, datë 13.2.2024 të Komisionerit”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Më tej, me qëllim lehtësimin e procesit dhe sigurimin e një zbatimi sa më efektiv të detyrave të përcaktuara, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me njësinë përgjegjëse të subjektit, si nëpërmjet korrespondencës elektronike, ashtu edhe përmes komunikimeve telefonike, duke ofruar asistencën e nevojshme për sqarimin e paqartësive të hasura gjatë procesit të zbatimit të plotë të vendimit të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 22, datë 13.2.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me rregullimet që ligji dhe aktet nënligjore kanë bërë për këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që të veprojë si më poshtë:

- Të përcaktojë nëpunësin civil/grup pune, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës në strukturën aktuale që janë pjesë e shërbimit civil dhe analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësi e kërkesave të veçanta të çdo pozicioni (përcaktimin e saktë të kërkesave lidhur me nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve dhe përvojën në punë).

- Ky material t’u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës (epropri direkt i pozicionit respektiv të punës dhe Sekretari i Përgjithshëm), siç përcaktohet në kreun IV, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Në lidhje me këtë pikë të vendimit, njësia përgjegjëse nëpërmjet shkresave me nr. 3698 prot., datë 18.11.2024; nr. 3733 prot.,;3728 prot.,;3729 prot.,;3730 prot.,;3731 prot., dhe nr. 3732 prot., datë 19.11.2024, të nënshkruara nga kryetari i bashkisë, ka njoftuar të gjitha njësitë e institucionit që të hartojnë përshkrimet e punës për secilin pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në vijim me shkresën nr. 4391 prot., datë 3.12.2025, Bashkia Has ka dërguar aktin nr.4390 prot., datë 3.12.2025, bashkëlidhur së cilit ndodhet lista përmbledhëse e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës përkatëse.

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues kërkohet që pasi të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përgatitë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës (*Struktura dhe organika e hollësishme e institucionit që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit dhe përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil*).

Vërehet se, për këtë pikë të vendimit nuk janë marrë masa konkrete nga aktorët të cilët ligji i ngarkon me detyrë për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës e për këtë arsye, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës.

Në pikën 4 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, në zbatim të përcaktimeve të pikës 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, të krijojë Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, i cili do të përbëhet nga tre anëtarë: njëri nga anëtarët është i ngarkuari me detyrën e analistit të punës, ose ndonjë funksion tjetër të menaxhimit të burimeve njerëzore, kurse dy anëtarët e tjerë janë nëpunës civilë me përvojë në institucion.

Konstatohet se, me Urdhrin nr. 61, datë 10.2.2025, *“Për ngritjen e Komitetit të Vlerësimit në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil të Bashkisë Has”* të Sekretarit të Përgjithshëm, është krijuar Komiteti i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil.

Në pikën 5 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Komiteti i Vlerësimit, që pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, të identifikojë saktësisht pozicionet e punës që do të vlerësohen. Vlerësimi duhet të bëhet duke u bazuar në përshkrimet e punës dhe metodologjinë e përcaktuar në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, të hartohet një listë përmbledhëse, ku të pasqyrohen pozicionet e punës të shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse sipas ligjit dhe aktit nënligjor rregullator të këtij aspekti të rëndësishëm të administrimit të shërbimit civil.

Nga verifikimi i akteve dhe komunikimet e kryera me njësinë përgjegjëse u konstatua se edhe kjo pikë e vendimit nuk ishte zbatuar.

Në pikën 6 të vendimit, Komisioneri ka kërkuar që pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil ku të shpallen për konkurrim të gjitha vendet vakante. Në këtë akt të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, në përputhje me strukturën e

institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të këtij procesi ku të përfshihet pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi.

Rezulton se, me Vendimin nr. 1, datë 24.2.2025, *“Për miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil në Bashkinë Has për vitin 2025”* Kryetari i Bashkisë ka miratuar planin vjetor të pranimi në shërbimin civil për vitin 2025. Në këtë akt janë përfshirë të gjitha pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin sikundër dhe pozicionet efektivisht të lira.

Në pikën 7 të vendimit objekt mbikëqyrje në vazhdim, është kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe njësia përgjegjëse e institucionit të hartojnë dhe miratojnë një plan veprimi për zbatimin e këtij vendimi paralajmërues, ku të përcaktohen qartë: a) veprimet administrative që do të kryhen në zbatim të detyrave të lëna në raportin përfundimtar dhe në këtë vendim; b) subjekti/ nëpunësi përgjegjës për kryerjen e veprimit; si dhe, c) afati/data brenda të cilës do të përfundojë kryerja e veprimit administrativ.

Kjo detyrë nuk është zbatuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe njësia përgjegjëse, duke sjellë mungesën e një plani të formalizuar dhe të miratuar për ndjekjen e masave të kërkuara.

Në pikën 8 është kërkuar që Kryetari i Bashkisë Has të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për 26 punonjës të emëruar me akte të përkohshme, të nxjerra në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, si dhe të rregullojë pasojat ligjore, me qëllim që pozicionet përkatëse të jenë efektivisht të lira në momentin e shpalljes për konkurrim pranë AKPA, duke respektuar parimet e shanseve të barabarta, profesionalizmit dhe transparencës.

Nga dokumentacioni i administruar në institucion, konstatojmë se nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit janë marrë masat e mëposhtme:

1. Me urdhrin nr. 33, datë 30.1.2025, punonjësja A.Rada është emëruar në pozicionin *“Drejtor”* Drejtoria e Mbrojtjes Civile, pozicion jashtë administrimit të shërbimit civil;
2. Me urdhrin nr. 81, datë 8.2.2025, është ndërprerë marrdhënia e punës për punonjësen J. Ukperaj;
3. Me urdhrin nr. 81353, datë 22.7.2024, është ndërprerë marrdhënia e punës për punonjësen N. Peka;
4. Me urdhrin nr. 77, datë 1.2.2024, është ndërprerë marrdhënia e punës për punonjësin A. Neza;
5. Me urdhrin nr. 187, datë 23.5.2025, punonjësi D. Çerkezi ka kaluar në një pozicion tjetër;
6. Me Urdhrin nr. 373, datë 22.10.2025, në përfundim të procedurës së konkurrimit për pranim në shërbimin civil është emëruar nëpunës civil F. Duraku në pozicionin *“Përgjegjës”* në Sektorin e Burimeve Njerëzore;

7. Me aktin nr. 4286 prot., datë 21.11.2025, institucioni ka informuar Komisionerin se në përfundim të procedurës së konkurrimit për pranim në shërbimin civil nëpunësja civile N. Laci është emëruar në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”.

Në pikën 9 të vendimit Komisioneri ka kërkuar të rregullohet ligjshmëria në lidhje me rastet e ngritjes në detyrë në kundërshtim me ligjin; Kryetari i Bashkisë Has të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit V.Daci, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Burimeve Njerëzore*”, me urdhrin nr. 267 (715 prot.), datë 11.9.2023, të kryetarit dhe S. Bardhoshi, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Ndihmës Ekonomike, Njësia Administrative Golaj*”, me urdhrin nr. 480, datë 15.9.2021, të kryetarit.

Rezulton se, marrëdhënia e punës për punonjësen V. Daci dhe punonjësin S.Bardhoshi është ndërprerë respektivisht me urdhrat nr. 300 , datë 11.6.2024, dhe nr. 410, datë 22.12.2023.

Në pikën 10, për përmirësimin e administrimit të shërbimit civil dhe procedurës së konkurrimit për pozicionin “*Specialist për Koordinimin Evropian*”, Komisioneri ka kërkuar të ndërmerren këto hapa:

- Të anulohet procedura e lëvizjes paralele për pozicionin “*Specialist për Koordinimin Evropian*”, duke nisur nga faza e dytë e konkurrimit, që është vlerësimi i kandidatëve për dokumentacionin dhe intervistën e strukturuar me gojë. Në këtë rast, të rregullohen pasojat duke anuluar aktet administrative në kundërshtim me ligjin të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën, që është pjesë e Raportit të mbikëqyrjes dhe të përsëritet procesi, duke nisur nga kjo fazë.
- Të nxirren aktet e reja për ngritjen e Komisionit të Brendshëm, i cili duhet të realizojë fazën e dytë të procedurës së lëvizjes paralele dhe të hartojë aktet e nevojshme që dokumentojnë kryerjen e kësaj faze.
- Njësia përgjegjëse të kryejë të gjitha veprimet e tjera të domosdoshme që përcakon ligji deri në nxjerrjen e aktit të emërimit, për nëpunësin që do të rezultojë fitues.

Grupi i punës konstatoi se, me urdhrin nr. 231, datë 25.4.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punës për punonjësen N.Muja e cila mbante pozicionin e punës “*Specialist për Koordinimin Evropian*”, duke e bërë objektivisht të pamundur zbatimin e hapave të mëtejshëm të kësaj pike të vendimit paralajmërues.

Në pikën 11 të vendimit, për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me procedurën e konkurrimit për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit*” dhe “*Përgjegjës i Pyjeve, Kullotave dhe Zjarreve*”, është kërkuar të kryhen veprimet si më poshtë:

- Të anulohen procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet “*Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit*” dhe “*Përgjegjës i Pyjeve, Kullotave dhe Zjarreve*” duke filluar nga faza e dytë e konkurrimit, që është vlerësimi i kandidatëve ku

përfshihet vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë. Në këtë rast, të rregullohen pasojat duke anuluar aktet administrative në kundërshtim me ligjin që janë pasqyruar në tabelën, që është pjesë e Raportit të mbikëqyrjes dhe të përsëritet procesi duke nisur nga kjo fazë.

- Të nxirren aktet e reja për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) i cili duhet të realizojë fazën e dytë të procedurës së ngritjes në detyrë dhe të hartojë aktet e nevojshme që dokumentojnë kryerjen e kësaj faze.
- Njësia përgjegjëse të kryejë të gjitha veprimet e tjera të domosdoshme që përcakton ligji deri në nxjerrjen e aktit të emërimit, për nëpunësin që do të rezultojë fitues në përfundim të procesit.

Rezulton se me Urdhrin nr. 167, datë 2.4.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punës për punonjësin A. Xhabexhia, i cili mbante pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit”, duke e bërë objektivisht të pamundur zbatimin e hapave të mëtejshëm të kësaj pike të vendimit paralajmërues. Ky pozicion me aktin nr. 334/1 prot., datë 19.9.2025, është shpallur për t’u plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrit. Sa i përket pozicionit tjetër, nga ana e institucionit nuk janë marrë masa.

Në pikën 12 të vendimit, në të cilën është lënë detyrë që të hartohen përshkrimet e punës me qëllim përcaktimin e qartë të pozicioneve që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil, ashtu siç është evidentuar gjatë analizës së pikës 3 më sipër, kjo detyrë rezulton e pazbatuar.

Në pikën 13 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore është udhëzuar që dosjet e personelit të plotësohen në përputhje me përcaktimet ligjore, duke përfshirë rastet për të cilat ishte konstatuar mungesa e raporteve mjekësore, me qëllim që të sigurohet përmbushja e të gjitha detyrimeve dokumentare të parashikuara nga legjislacioni i shërbimit civil.

Nga verifikimi i kryer nga grupi i punës, i cili shqyrtoi disa dosje të përzgjedhura rastësisht, rezultoi se kjo kërkesë nuk është përmbushur në mënyrë të rregullt.

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkia Has ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr. 22, datë 13.2.2024, të Komisionerit.

Sa i takon dy aspekteve më problematike që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, vlen të theksohet se nga institucioni kanë filluar të merren masa.

Duke qenë se këto nuk janë procese të lehta dhe kërkojnë një periudhë kohore të domosdoshme përtej afatit paralajmërues të përcaktuar nga Komisioneri, si dhe mbështetur në faktin se njësia përgjegjëse ka shfaqur paqartësi në njohjen dhe më tej zbatimin e saktë të ligjit lidhur me procesin e ristrukturimit, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin nuk janë përfshirë të gjitha në planin e rekrutimit, me synim

plotësimin e tyre në përputhje të plotë me procedurat ligjore, vlerësojë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për strukturat e bashkive. Në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni mund të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme ose tematike gjatë vitit 2026.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 22, datë 13.2.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Has dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Has.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha